



Pranimi / Dostizuar Received/Desivory	19-04-2023	3	viti god Year
Organ /Jedinita Org /Unit	No Prot Pr Prot No	Shloca Prilog Appendix	Shera Kolicema Quantity
SKAMSHK	3696	2023	1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.469/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.469/2023 të datës 08.03.2023, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 18.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr.469/2023 e datës 08.03.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. ANULOHET** konkursi për emrin e grupit „Specialistë të Shkencave Shoqërore” me numër reference RN00010634 i datës 16.12.2022 i shpallur nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë –Ministria e Punëve të Brendshme për pozitën „Zyrtar për Arkivë 1” në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe shfuqizohen të gjitha vendimet që rrjedhin nga kjo procedurë e rekrutimit.
- III. OBLIGOHET** Drejtori i Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, që të ndër marrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore, me qëllim të zbatimit të këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe nenit 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, fillimisht me datën 16.12.2022 ka njoftuar lidhur me konkursin, ndërsa me datën 06.01.2023 ka shpallur konkursin për pranim për emrin e grupit Specialist të Shkencave Shoqërore në Ministrinë Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, lidhur me pozitën *Zyrtar për Arkiv 1* në Departamentin për Shërbime Administrative në Prishtinë, për klasën e pozitës Profesional 3.

Në bazë të listës së aplikacioneve në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi. Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme (tutje MPB), me datën 01.02.2023 ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.09/2023, sipas të cilit ankuesi është njoftuar se nuk është përfshirë në listën e ngushtë lidhur me konkursin për pozitën në fjalë.

Kundër vendimit për mos përfshirjen në listën e ngushtë, me datën 01.02.2023 përmes sistemit në mënyrë elektronike, ka parashtruar ankesë në Njësinë e Burimeve Njerëzore të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë. Kjo e fundit me datën 10.02.2023 ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.02/2023, sipas të cilit e ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar lidhur me mos përfshirjen në listën e ngushtë.

I pakënaqur me vendimin lidhur me mos përfshirjen në listën e ngushtë, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankuesi përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmsk@rks-gov.net me datën 08.03.2023, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 2474/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkeljes së dispozitave ligjore, me pretendimet ankimore se i njëjti është person me aftësi të kufizuara dhe se i njëjti ka parashtruar kërkesën për diplomë tek fakulteti ku ka mbaruar studimet dhe thekson faktin se pret të pajiset vetëm me diplomë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:2474/2023 të datës 08.03.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr.02/2023 të datës 10.02.2023 nga Njësia e Burimeve Njerëzore në DMZP; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 13.03.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 31.03.2023 nga Ministria e Punëve të Brendshme së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Kopjen e konkursit me numër reference RN00010634 të datës 16.12.2022; Listën e aplikantëve e gjeneruar tek SIMBNJ lidhur me kandidatet e aprovuar dhe refuzuar; Vendimin Nr.09/2023 të datës 01.02.2023 nga Njësia e Burimeve Njerëzore në DMZP; Ankesën e ankuesit e parashtruar përmes sistemit tek DMZP; Vërtetimin me numër protokollit A5-002/23 të datës 09.01.2023 nga Kolegji AAB; Njoftimin e datës 02.02.2023 lidhur me listën e ngushtë të kandidatëve aplikues nga DMZP; Vendimin Nr.15/99 te datës 30.09.2022 lidhur me formimin e komisionit të pranimit për institucionet e administratës

shtetërore; Aplikacionin e ankuesit të datës 11.01.2023 së bashku me diplomën e shkollës së mesme me Nr.1970/10 të datës 13.09.2010, Certifikatën mbi evidencën penale të datës 04.01.2023, Certifikatën e datës 22.05.2014, Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit si dhe Vendimin e datës 13.06.2017 lidhur me njohjen e të drejtës në pension.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Pasi i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit si dhe të gjitha provat e lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se kriteret e konkursit për emrin e grupit „Specialist të Shkencave Shoqërore“, i shpallur nga Ministria e Punëve të Brendshme sipas konkursit me numër të referencës RN00010634 në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural lidhur me pozitën “Zyrtar për Arkivë 1” në Departamentin për Shërbime Administrative në Prishtinë për klasën e pozitës profesional 3, kanë qenë si në vijim:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare Juridik, Ekonomik dhe Filologjik me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to.*
- *Kualifikime të posaçme formale:*
- *Pa përvojë pune:*
- *Dëshminë se është person me aftësi të kuafizuara.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së shpalljes së konkursit dhe zhvillimit të procedurave të rekrutimit deri në fazën kur ankuesi ka parashtruar ankesë, ka analizuar dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil e cila ka qenë në fuqi në kohën kur është zhvilluar procedura, konkretisht tek shtojca Nr.2, Kodi i grupit 14. Gr. të kësaj rregulloreje, janë përcaktuar kriteret lidhur me fushën e kërkuar të arsimit për secilën kategori të shërbimit civil, konkretisht për emrin e grupit *Specialistë të Shkencave Shoqërore* fusha e kërkuar e arsimit është ajo “*Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkenca Politike, Psikologji, Punë Sociale e të tjera të ngjashme*, ndërsa tek kërkesat e përgjithshme formale sipas kushteve të konkursit i shpallur me datën 16.12.2022 sipas numrit të referencës RN00010634 nga Ministria e Punëve të Brendshme për emrin e grupit *Specialistë të Shkencave Shoqërore* janë përfshirë vetëm drejtimet nga fusha e Juridikut, Ekonomikut dhe Filologjikut për fushën e caktuar të arsimit të kërkuar, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit ka konstatuar se me rastin e mos përfshirjes së fushës së arsimit Sociologji, Antropologji, Histori, Shkenca Politike, Psikologji, Punë Sociale e të ngjashme si kriter i konkursit për emrin e grupit *Specialist të Shkencave Shoqërore* siç përcaktohet me dispozitat e kësaj rregulloreje, Ministria e Punëve të Brendshme ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, konkretisht nenin 6 paragrafin 1 dhe 2 ku përcaktohet se: “*Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, nëpunësit të Shërbimit Publik dhe nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve. 2. Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive*” si dhe në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës konkretisht nenin 4 paragrafin 2 ku përcaktohet se: “*Parimet e pranimit dhe avancimit në karrierë: Nëpunësit civil pranohen dhe avancohen në*

karrierë në bazë të meritës të vlerësuar në bazë të një procedure konkurruese dhe transparente, të përcaktuar në bazë të Ligjit dhe akteve përkatëse nënligjore”.

Andaj, Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë si dhe analizimit të dispozitave ligjore lidhur me kushtet dhe kriteret e pranimit në shërbimin civil, duke marrë për bazë edhe konstatimet e pasqyruara si në arsyetimin e këtij vendimi, ka konstatuar se konkursi i shpallur me datën 16.12.2022 për emrin e grupit *Specialistë të Shkencave Shoqërore*, i shpallur nga Ministria e Punëve të Brendshme sipas konkursit me numër të referencës RN00010634 në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural lidhur me pozitën “Zyrtar për Arkivë 1” në Departamentin për Shërbime Administrative në Prishtinë për klasën e pozitës profesional 3, është bërë në kundërshtimin me nenin 4 paragrafin 2 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe në kundërshtim me nenin 6 paragrafin 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe mbi këtë bazë ka vendosur të anulojë konkursin e lartë cekur si dhe të shfuqizojë çdo akt tjetër administrativ që rrjedh nga kjo procedurë e rekrutimit, ndërsa ankesa e ankuesit është aprovuar mbi bazën e kësaj të gjeture. Kolegji i Këshillit nuk është lëshuar më tej në shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, meqenëse shpallja e konkursit nuk ka qenë në harmoni me dispozitat akteve ligjore të përcaktuara si më lartë.

Nisur nga konstatimet si më lartë, Kolegji duke u bazuar në nenin 52 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative konstaton se një procedurë rekrutimi e përfshirë më shkelje të dispozitave materiale konsiderohet procedurë e paligjshme, kështu që me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë, Kolegji në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.469/2023, datë 18.04.2023.

Ardita Perçuku-Shyti



Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI



Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë;
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë-MPB;
- Udhëheqësit të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, DMZP-MPB;
- Arkivët të KPMSHCK- së.